

V E N D I M

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga :

Xhezair Zaganjori - Kryesues
Ardian Dvorani - Anëtar
Andi Çeliku - Anëtar
Evelina Qirjako - Anëtar
Arjana Fullani - Anëtar

me sekretare gjyqësore **Ermelinda Kadiu**, në Tiranë, sot më datë **30.05.2017**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative që i përket:

PADITËS: Razie Llalla;

TË PADITUR: 1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
2. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë;

PERSON I TRETË: Departamenti i Administratës Publike;

OBJEKTI: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimtarisë administrative gjatë procedimit disiplinor, përfunduar sipas vendimit nr. 1061, datë 23.06.2014 të Komisionit të Disiplinës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për dhënie e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” deklaruar lirimi prej shërbimit civil sipas vendimit nr. 43767/1 prot, datë 03.07.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.
Rregullimin e pasojave ligjore të paligjshmërisë të veprimtarisë administrative gjatë procedimit disiplinor ku është vendosur “lirim nga detyra”, si më poshtë:

1. Rivendosje e të drejtave të mia si nëpunëse civile, duke u urdhëruar palët e paditura të më rikthejnë në shërbimin civil , pranë DRT Tiranë në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;
2. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë për shkak të pasojave të ardhura si rezultat i paligjshmërisë në procedurat e kryera për largimin tim nga shërbimi civil, duke më dëmshpërblyer humbjet e shkaktuar si rezultat i humbjes së punës dhe rrjedhimisht pagës.

Detyrimin e palës së paditur të më paguajë të gjitha shpenzimet gjyqësore.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurave disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”. Udhëzimi nr. 01, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Elementët Kryesorë Proceduralë dhe Materialë të Ecurisë dhe Shqyrtimit të Shkeljeve Disiplinore”. Nenet 32, 153, 154, 154/a të Kodit të Procedurës Civile. Nenet 7/ç, 11/2, 15/c, 16/1, 17/1/g dhe 18/5 të Ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5660, datë 14.10.2014, ka vendosur:

Pranimin e padisë.

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimtarisë administrative gjatë procedimit disiplinor, përfunduar sipas vendimit nr. 1061, datë 23.06.2014, të Komisionit të Disiplinës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për dhënien e masës disiplinore “largim nga shërbimi civil”, deklaruar me lirim prej shërbimit civil sipas vendimit nr. 43767/1 prot., datë 03.07.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Urdhëron rregullimin e pasojave të krijuara prej këtij veprim administrativ absolutisht të pavlefshëm, si me poshtë:

- *Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë të rikthejë nëpunësin civil Razie Llalla në shërbimin civil, në pozicionin e punës Inspektore e Parë, në Sektorin e Kontrollit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”;*
- *Pagimin e pagës për pozicionin e punës si nëpunës civil, Inspektore e Parë, në Sektorin e Kontrollit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë deri në momentin e rikthimit në punë sipas këtij vendimi si zhdëmtim i pasojave ekonomike të pësuar nga paligjshmëria e veprimit tjetër administrativ të palës së paditur, vendimi nr. 1061, datë 23.06.2014, të Komisionit Disiplinor pranë Drejtorisë së Përgjithshme.*

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 856, datë 23.04.2015, ka vendosur: **Lënien në fuqi të vendimit nr. 5660, datë 14.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.**

Kundër vendimit nr. 856, datë 23.04.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 5660, datë 14.10.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin padisë

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 63, shkronja “e”, të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

V E N D O S I:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 856, datë 23.04.2015, të Gjykatës Administrativ të Apelit.

Tiranë, më 30.05.2017

**Nr. 31003-01908-00-2015 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2017-923 i Vendimit (672)**